Hrana koja se čuva u ladicama odjeljka hladnjaka zamrznuta je.

- Temperatura hladnjaka podešena je na vrlo visoku temperaturu. >>>Podesite temperaturu hladnjaka na hladnije i provjerite.

Temperatura u hladnjaku ili zamrzivaču je previše niska.

- Temperatura hladnjaka podešena je na vrlo visoku temperaturu. >>>Postavka temperature odjeljka hladnjaka utječe na temperaturu zamrzivača. Mijenjajte temperature hladnjaka ili zamrzivača i čekajte dok odgovarajući odjeljci ne postignu dovoljnu temperaturu.
- Često ste otvarali vrata ili ih ostavljali odškrinutima na duže vrijeme. >>>Nemojte često otvarati vrata.
- Vrata su odškrinuta. >>>Zatvorite vrata do kraja.
- Hladnjak je nedavno uključen ili je u njega stavljena hrana. >>>To je normalno. Kada je hladnjak nedavno uključen ili je u njega stavljena hrana, trebat će dulje vremena da postigne postavljenu temperaturu.
- Možda su nedavno u hladnjak stavljene velike količine vruće hrane. >>>Ne stavljajte vruću hranu u hladnjak.

Vibracije ili buka.

- Pod nije ravan ili stabilan. >>> Ako se hladnjak ljulja kad se lagano pomiče, izbalansirajte ga podešavanjem nožica. Također pripazite da je pod ravan i da dovoljno jak da može nositi hladnjak.
- Predmeti stavljeni na hladnjak mogu uzrokovati buku. >>>Uklonite predmete s hladnjaka.

# Otklanjanje kvara

Iz hladnjaka se čuje buka poput protoka tekućine, prskanja itd.

- Protok tekućine i plinova događa se u skladu s radnim principima hladnjaka. To je normalno i ne predstavlja kvar.

Iz hladnjaka dopire zviždanje.

- Ventilatori se upotrebljavaju za hlađenje hladnjaka. To je normalno i ne predstavlja kvar.

Kondenzacija na unutarnjim zidovima hladnjaka.

- Toplo i vlažno vrijeme povećava nastanak leda i kondenziranje. To je normalno i ne predstavlja kvar.
- Često ste otvarali vrata ili ih ostavljali odškrinutima na duže vrijeme. >>>Nemojte često otvarati vrata. Zatvorite ih ako su otvorena.
- Vrata su odškrinuta. >>>Zatvorite vrata do kraja.

Vlaga se pojavljuje na vanjskom dijelu hladnjaka ili između vrata.

- Možda ima vlage u zraku; to je potpuno normalno kad je vrijeme vlažno. Kad je vlažnost manja, kondenzat će nestati.

Neugodan miris unutar hladnjaka.

- Ne obavlja se redovito čišćenje.  
>>>Redovito čistite unutrašnjost hladnjaka spužvom, mlakom vodom ili sodom bikarbonom otopljenom u vodi.
- Neugodan miris možda uzrokuje neke posude ili materijali pakiranja.  
>>>Upotrijebite drugu posudu ili drugačiju marku materijala za pakiranje.
- Hrana je stavljena u hladnjak u nepokrivenim posudama. >>>Čuvajte hranu u zatvorenim posudama.  
Mikroorganizmi koji se šire iz nepokrivenih posuda mogu uzrokovati neugodne mirise.
- Iz hladnjaka uklonite hranu kojoj je istekao rok i koja je pokvarena.

Vrata se ne zatvaraju.

- Pakiranja hrane možda sprječavaju zatvaranje vrata. >>>Uklonite pakiranja hrane koja smetaju vratima.
- Hladnjak ne stoji ravno na podu.  
>>>Podesite nožice da biste uravnotežili hladnjak.
- Pod nije ravan ili čvrst. >>>Provjerite je li pod ravan i može li podnijeti težinu hladnjaka.

Zaglavljani su odjeljci za povrće.

- Hrana dodiruje vrh ladice. >>>Presložite hranu u ladicu.

Ako je površina proizvoda vruća.

- Visoke temperature mogu se primijetiti između dvaju vrata, na bočnim pločama i na stražnjoj rešetki tijekom rada uređaja. Ovo je normalno i nije potrebna usluga održavanja!

## **ODRICANJE OD ODGOVORNOSTI / UPOZORENJE**

Neke (jednostavne) kvarove može ukloniti krajnji korisnik bez sigurnosnih problema ili opasnosti, pod uvjetom da se izvode u granicama i u skladu s sljedećim uputama (pogledajte odjeljak „Samostalno popravlanje“).

Stoga, osim ako nije drugačije naglašeno u donjem odjeljku „Samostalno popravlanje“, popravke će obavljati registrirani profesionalni serviseri kako bi se izbjegli sigurnosni problemi. Registrirani profesionalni serviser je profesionalni serviser kojem je proizvođač odobrio pristup uputama i popisu rezervnih dijelova ovog proizvoda prema metodama opisanim u zakonodavnim aktima u skladu sa Direktivom 2009/125/EC.

**Međutim, samo servisni agenti (tj. ovlašteni profesionalni serviseri) do kojih možete doći putem telefonskog broja koji je naveden u korisničkom priručniku/jamstvenoj kartici ili putem ovlaštenog prodavača, mogu pružiti uslugu pod uvjetima jamstva. Stoga imajte na umu da popravke koje izvrše profesionalni serviseri (koje nije ovlastio Beko) poništavaju jamstvo.**

### **Samostalno popravlanje**

Samostalno popravlanje može izvršiti krajnji korisnik za sljedeće rezervne dijelove: ručke vrata, šarke vrata, ladice, košare i brtve vrata (ažurirani popis također je dostupan na support.beko.com od 1. ožujka 2021. godine).

Štoviše, kako bi se osigurala sigurnost proizvoda i spriječio rizik od ozbiljnih ozljeda, spomenuto samostalno popravlanje mora se izvršiti prema uputama u korisničkom priručniku za samostalno popravlanje, a dostupno je i na support.beko.com. Radi vaše sigurnosti, prije pristupanja bilo kakvom samostalnom popravljaju isključite proizvod.

Popravka ili pokušaji popravka od strane krajnjeg korisnika za dijelove koji nisu uključeni u popis i/ili za koje se ne slijede upute u korisničkom priručniku za samostalno popravlanje ili koji su dostupni na support.beko.com, mogu dovesti do sigurnosnih problema koji se ne mogu pripisati tvrtki Beko i poništiti će jamstvo proizvoda.

Stoga se krajnjim korisnicima preporučuje da se uzdrže pokušaja popravka koji nisu na spomenutom popisu rezervnih dijelova i da se u takvim slučajevima obrate ovlaštenom profesionalnom serviseru ili registriranom profesionalnom serviseru. U suprotnom, takvi pokušaji krajnjih korisnika mogu uzrokovati sigurnosne probleme i oštetiti proizvod, te tako izazvati požar, poplavu, strujni udar i ozbiljne osobne ozljede.

Na primjer, ali se ne ograničavajući na, za sljedeće popravke mora se obratiti ovlaštenom profesionalnom serviseru ili registriranom profesionalnom serviseru: kompresor, rashladni sklop, glavna ploča, inverter ploča, ploča zaslona i slično.

Proizvođač/prodavač ne može se smatrati odgovornim u bilo kojem slučaju kada se krajnji korisnici ne pridržavaju gore navedenog.

Dostupnost rezervnih dijelova hladnjaka koji ste kupili je 10 godina.

Tijekom tog razdoblja originalni rezervni dijelovi bit će dostupni za ispravan rad hladnjaka

Minimalno trajanje jamstva hladnjaka koji ste kupili je 24 mjeseca.

Ovaj je proizvod opremljen izvorom rasvjete „G“ energetskog razreda.

Izvor rasvjete u ovom proizvodu mora zamijeniti samo profesionalni serviser.

**I nderuar klient,**

**Ju lutemi që të lexoni këtë manual para se të përdorni produktin.**

Faleminderit që keni zgjedhur këtë produkt. Dëshirojmë që të arrini efikasitetin optimal nga ky produkt i cilësisë së lartë i cili është prodhuar me teknologjinë e fundit. Për ta bërë këtë, lexoni me vëmendje këtë manual dhe çfarëdo dokumentacioni tjetër të ofruar para se të përdorni produktin dhe mbajeni si referencë. Kushtojini vëmendje të gjitha informacioneve dhe paralajmërimeve në manualin e përdoruesit. Në këtë mënyrë, do ta mbron vetën dhe produktin tuaj kundër rreziqeve që mund të ndodhin. Ruajeni manualin e përdoruesit. Përfshijeni këtë udhëzues me pajisjen nëse ia dorëzoni dikujt tjetër.

Simbolet në vijim përdoren në udhëzuesin e përdoruesit:



Rrezik që mund të shkaktojë vdekje ose lëndim.

**NJOFTIM** Një rrezik që mund të shkaktojë dëme materiale te produkti ose përreth tij



Informacione të rëndësishme ose këshilla të dobishme.



Ruajeni manualin e përdoruesit.

|  <b>INFORMACIONE</b>                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <div><b>ENERGY</b></div> <div><div>SUPPLIER'S NAME</div><div>MODEL IDENTIFIER → (*)</div></div> <div><div>A</div><div>A</div></div> | <p>Informacionet e modelit të ruajtura në bazën e të dhënave të produktit mund të arrihen duke hyrë në faqen e mëposhtme të internetit dhe duke kërkuar për identifikuesin e modelit tuaj (*) që gjendet në etiketën e energjisë.</p> <p><a href="https://eprel.ec.europa.eu/">https://eprel.ec.europa.eu/</a></p> |

|                                                                         |                  |
|-------------------------------------------------------------------------|------------------|
| <b><u>1 Udhëzimet lidhur me sigurinë.....</u></b>                       | <b><u>3</u></b>  |
| ⚠ 1.1 Qëllimi i përdorimit .....                                        | 3                |
| ⚠ 1.2 Siguria e fëmijëve,<br>personave dhe kafshëve të pambrojtura..... | 3                |
| ⚠ 1.3 Siguria elektrike .....                                           | 4                |
| ⚠ 1.4 Siguria gjatë manovrimit .....                                    | 4                |
| ⚠ 1.5 Siguria gjatë instalimit .....                                    | 4                |
| ⚠ 1.6 Siguria operacionale .....                                        | 5                |
| ⚠ 1.7 Siguria e mirëmbajtjes dhe pastrimit.....                         | 7                |
| ⚠ 1.8 HomeWhiz .....                                                    | 7                |
| ⚠ 1.9 Ndriçimi .....                                                    | 7                |
| <b><u>2 Udhëzimet mjedisore.....</u></b>                                | <b><u>8</u></b>  |
| <b><u>3 Frigoriferi juaj.....</u></b>                                   | <b><u>9</u></b>  |
| <b><u>4 Instalimi .....</u></b>                                         | <b><u>10</u></b> |
| 4.1. Vendi i përshtatshëm për instalim .....                            | 10               |
| 4.2. Rregullimi i këmbëve .....                                         | 11               |
| 4.3. Lidhja elektrike .....                                             | 11               |
| 4.4. Lidhja e pykave të plastikes .....                                 | 11               |
| <b><u>5 Përgatitja.....</u></b>                                         | <b><u>12</u></b> |
| <b><u>6 Përdorimi i produktit.....</u></b>                              | <b><u>13</u></b> |
| 6.1 Ndërrimi i llambës ndriçuese.....                                   | 14               |
| 6.2 Ndërrimi i drejtimit të hapjes së derës.....                        | 14               |
| 6.3 Paralajmërimi i hapjes së derës .....                               | 14               |
| 6.4. Moduli i deodoruesit.....                                          | 15               |
| 6.5. Drita e kaltër/"HarvestFresh" .....                                | 16               |
| 6.6. Koshi i perimeve me lagështi të kontrolluar....                    | 16               |
| 6.7.Ngrirja e ushqimeve të freskëta .....                               | 17               |
| 6.8.Rekomandimet për ruajtjen<br>ushqimet e ngrira .....                | 18               |
| 6.9.Hollësime rreth ngrirësit të thellë .....                           | 18               |
| 6.10.Vendosja e ushqimeve .....                                         | 19               |
| <b><u>7 Mirëmbajtja dhe pastrimi.....</u></b>                           | <b><u>20</u></b> |
| <b><u>8 Zgjidhja e problemeve.....</u></b>                              | <b><u>21</u></b> |

# 1 Udhëzimet lidhur me sigurinë

- Kjo pjesë përmban udhëzimet e sigurisë së nevojshme për të parandaluar rrezikun e lëndimit personal ose dëmit material.
- Kompania jonë nuk duhet të mbahet përgjegjëse për dëmet që mund të ndodhin në rast se nuk respektohen këto udhëzime.

**!** Operacionet e instalimit dhe riparimit duhet gjithmonë të kryhen nga Shërbimet e Autorizuara.

**!** Gjithmonë përdorni pjesë rezervë dhe aksesore origjinale.

**!** Pjesët rezervë origjinale do të ofrohen për 10 vjet pas datës së blerjes së produktit.

**!** Mos riparoni ose zëvendësoni një pjesë të produktit përveç nëse specifikohet në mënyrë të veçantë në manualin e përdoruesit.

**!** Mos bëni asnjë ndërhyrje në produkt.

## **!** 1.1 Qëllimi i përdorimit

- Ky produkt nuk është destinuar për përdorim komercial dhe nuk duhet të përdoret jashtë qëllimit të synuar.

Ky produkt është destinuar për funksionimin e ambienteve të brendshme, shtëpiake ose të ngjashme. Për shembull;

- në kuzhina të dyqaneve, zyrave ose ambienteve të tjera pune, - në shtëpi të fermave

- Në njësitë të hoteleve, moteleve ose objekteve të tjera pushimi që përdoren nga klientët
- në bujtina, ose ambiente të tjera të ngjashme,
- Në shërbime të furnizimit të ushqimit dhe përdorime të ngjashme jo-shitëse.

Ky produkt nuk duhet të përdoret në ambiente të hapura ose të mbyllura siç janë anijet, ballkonet ose tarracat. Ekspozimi i produktit në shi, borë, dritën e diellit dhe në erë mund të shkaktoj rrezik të zjarrit.

## **!** 1.2 Siguria e fëmijëve, personave dhe kafshëve të cenuseshme

- Ky produkt mund të përdoret nga fëmijët e moshës 8 vjeç e lart dhe personat me aftësi të pazhvilluara fizike, shqisore ose mendore ose mungesë përvoja dhe njohurie nëse atyre u është dhënë mbikëqyrje ose udhëzime në lidhje me përdorimin e pajisjes në një mënyrë të sigurt të produktit si dhe rreziqet e përfshira.
- Fëmijët ndërmjet 3 dhe 8 vjeç lejohen të vendosin dhe nxjerrin ushqim në/nga produkti më i ftohtë.
- Produktet elektrike janë të rrezikshme për fëmijët dhe kafshët. Kafshët dhe fëmijët nuk duhet të luajnë, të ngrihen mbi ose të hynë në produkt.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhet të kryhet nga fëmijët përveç nëse dikush i mbikëqyrë at.a
- Mbani materialet e paketimit larg nga fëmijët. Rrezik nga lëndimi dhe asfiksia.
- Para se të hidhni produktet e vjetra që nuk duhet të përdoren më:
  1. Hiqeni kordonin e rrymës nga priza.
  2. Prisni kordonin e rrymës dhe hiqeni nga pajisja së bashku me prizën.
  3. Mos i hiqni raftet dhe sirtarët nga produkti për të parandaluar që fëmijët të futen brenda pajisjes.
  4. Hiqni dyert.
  5. Ruajeni produktin në atë mënyrë që të mos përmbysset.
  6. Mos lejoni fëmijët të luajnë me produktin e copëzuar.
- Mos e largoni produktin duke e gjuajtur në zjarr. Rrezik nga eksplodimi

# Udhëzimet lidhur me sigurinë

- Nëse ekziston një dry në derën e produktit, mbajeni çelësin jashtë përdorimit të fëmijëve.

## 1.3 Siguria elektrike

- Produkti nuk duhet të futet në prizë gjatë operacioneve të instalimit, mirëmbajtjes, pastrimit, riparimit dhe transportimit.
- Nëse kordoni i rrymës është i dëmtuar, duhet të zëvendësohet nga shërbimi i autorizuar për të evituar ndonjë rrezik që mund të ndodhë.
- Mos e futni kordonin e rrymës nën produkt ose në pjesën e pasme të produktit. Mos vendosni gjësende të rënda mbi kordonin e rrymës. Kordoni i rrymës nuk duhet të lakohet, të shtypet, dhe të bie në kontakt me ndonjë burim të nxehtësisë.
- Mos përdorni kordon zgjatës, pajisje me shumë priza ose konvertor për të operuar produktin.
- Pajisjet me shumë priza ose furnizimi portativ me energji elektrike mund të kenë nxehje të tepër dhe të shkaktojnë zjarr. Prandaj, mos të keni një pajisje me shumë priza prapa ose afër produktit.
- Priza duhet të jetë e lehtë për t'u qasur. Nëse kjo nuk është e mundur, në instalimin elektrik duhet të ketë një mekanizëm i cili plotëson legjislationin elektrik dhe që shkëput të gjitha terminalet nga rrjeti (siguresa, çelësi, çelësi kryesor etj.).
- Mos prekni prizën me duar të lagura.
- Kur e shkëputni pajisjen nga priza, mos e mbani kordonin e rrymës, por prizën.

## 1.4 Siguria gjatë manovrimit

- Ky produkt është i rëndë, mos e bartni vetë.

- Mos e mbani produktin nga dera e tij gjatë manovrimit me produkt.
- Bëni kujdes që të mos e dëmtoni sistemin e ftohjes dhe gypat gjatë manovrimit me produkt. Mos e vëni produktin në funksion nëse gypat janë të dëmtuar dhe kontakti një shërbim të autorizuar.

## 1.5 Siguria gjatë instalimit

- Kontakti shërbimin e autorizuar për instalimin e produktit. Për të përgatitur produktin për instalim, shikoni informacionet në udhëzuesin për përdorues dhe sigurohuni që pajisjet elektrike dhe ato të ujit janë siç kërkohet. Nëse instalimi nuk është i përshtatshëm, thirrni një electricist dhe hidraulik të kualifikuar në mënyrë që t'i kryejnë aranzhimet e nevojshme. Përndryshe, mund të ndodhë shkaktohen shoku elektrik, zjarri, probleme me pajisje ose lëndime.
- Kontrolloni për ndonjë dëmtim në produkt para se ta instaloni atë. Mos e instaloni produktin nëse është i dëmtuar.
- Vendoseni produktin në një sipërfaqe të sheshtë dhe të fortë dhe drejtpeshoni me këmbët rregulluese. Përndryshe, frigoriferi mund të përmbysset dhe shkaktojë dëmtime.
- Produkti mund të instalohet në një ambient të thatë dhe të ajrosur. Mos mbani qilima, tepihë ose mbulesa të ngjashme për dysheme nën produktin. Kjo mund të shkaktojë rrezik të zjarrit si pasojë e ventilimit/ajrosjes të papërshtatshëm/së papërshtatshme.
- Mos i bllokoni ose mbulonin vrimat e ventilimit. Përndryshe, konsumimi i energjisë elektrike mund të rritet dhe mund të ndodhin dëmtime ndaj produktit tuaj.

## Udhëzimet lidhur me sigurinë

- Mos lidhni produktin në sistemet e furnizimit siç janë pajisjet e furnizimit me energji diellore. Përndryshe, produkti juaj mund të dëmtohet si rezultat i luhatjeve të papritura të tensionit!
- Sa më shumë ftohës të përmbajë një frigorifer, aq më e madhe do të jetë dhoma e instalimit të tij. Në dhoma shumë të vogla, mund të ndodhë një përzierje e ndezshme mes gazit dhe ajrit në rast të rrjedhjes së gazit në sistemin e ftohjes. Kërkohej të paktën 1 m<sup>3</sup> vëllim për çdo 8 gram ftohës. Sasia e ftohësit në dispozicion në produktin tuaj specifikohet në „Type Label“ - Etiketën e llojit.
- Vendi i instalimit të produktit nuk duhet të jetë i ekspozuar në dritën e drejtpërdrejtë të diellit dhe nuk duhet të jetë në afërsi të një burimi të nxehtësisë siç janë sobat, radiatorët etj...

Nëse nuk mund të parandaloni instalimin e produktit në afërsi të një burimi të nxehtësisë, mund të përdorni një pllakë të përshtatshme izoluese dhe distanca minimale nga burimi i nxehtësisë duhet të jetë siç specifikohet më poshtë.

- Së paku 30 cm larg nga burimet e ngrohjes siç janë sobat, njësitë e ngrohjes dhe radiatorët, etj...
- Së paku 5 cm larg nga furrat elektrike.
- Produkti juaj ka nivelin e mbrojtjes I. Vendoseni produktin në rrymë në një prizë të vendosur në mur e cila përputhet me vlerat e tensionit, korrentit dhe frekuencës të cilat specifikohen në etiketën e llojit. Priza duhet të jetë e pajisur me një siguresë me një shkallë prej 10 A - 16 A. Kompania jonë nuk do të jetë përgjegjëse për dëmet që do të shkaktohen si rezultat i përdorimit të produktit pa u siguruar lidhjet e tokës dhe elektrike të kryera sipas rregullave lokale ose rregulloret kombëtare.
- Kordoni i rrymës së produktit duhet të jetë i ç'kyçur gjatë instalimit. Përndryshe mund të ndodhë një rrezik i shokut elektrik ose lëndimit.

- Mos e vendosni produktin në priza të lirshme, të thyera, të ndotura, të yndyrshme ose priza që kanë dalë nga instalimet e tyre me rrezik të kontaktit me ujë.
- Vendoseni kordonin e rrymës dhe plastikeve ndihmëse (nëse ekzistojnë) të produktit në mënyrë që të mos shkaktojnë rrezik të rrëzimit.
- Depërtimi i lagështisë në pjesët e ndezura ose në kordonin e rrymës mund të shkaktojë lidhje të shkurtër. Prandaj, mos e përdorni produktin në ambiente me lagështi ose në zona ku uji mund të spërkat (p.sh. garazh, dhomë e larjes së rrobave, etj.) Nëse frigoriferi është i lagur me ujë, largojeni nga priza dhe kontakti një shërbim të autorizuar.
- Mos e lidhni frigoriferin tuaj me pajisje të kursimit të energjisë. Këto sisteme janë të dëmshme për produktin tuaj.



### 1.6 Siguria operationale

- Mos përdorni tretës kimikë në produkt. Këto materiale përmbajnë rreziqe të eksplozimit.
- Në rast të një defekti të produktit, hiqeni nga priza dhe mos e përdorni derisa të riparohet nga shërbimi i autorizuar. Ekziston rreziku i shokut elektrik.
- Mos vendosni një burim flake (p.sh. qirinj, cigare, etj.) mbi produktin ose në afërsi të tij.
- Mos hipni mbi produkt. Rrezik i rrëzimit dhe lëndimit!
- Mos shkaktoni dëme në gypat e sistemit të ftohjes duke përdorur mjete të mprehta dhe shpuese. Ftohësi që spërkat në rast të shpimit të gypave të gazit, zgjatimeve të gypave ose veshjeve të sipërme të sipërfaqes mund të shkaktojë acarim të lëkurës dhe lëndime të syve.
- Mos vendosni dhe mos përdorni pajisje elektrike brenda frigoriferëve/frigoriferit të thellë, përveç rasteve kur rekomandohet nga prodhuesi.

## Udhëzimet lidhur me sigurinë

- Mos bllokoni asnjë pjesë të duarve ose të trupit tuaj në pjesët lëvizëse brenda produktit. Kini kujdes që të mos bllokoni gishtërinjtë në mes të frigoriferit dhe derës së tij. Kujdes gjatë hapjes ose mbylljes së derës nëse ka fëmijë përreth.
- Mos vendosni akullore, kuba akulli apo ushqime të ngrira në gojë sapo t'i keni nxjerrë nga ngrirja. Rrezik nga morthi!
- Mos i prekni me duar të lagura muret e brendshme, pjesët metalike të ngrirësit ose ushqimet e ruajtura brenda frigoriferit. Rrezik nga morthi!
- Mos vendosni kanaçe me gaz ose kanaçe dhe shishe që përmbajnë lëngje që mund të ngrihen në dhomëzën e ngrirësit. Kanaçet ose shishet mund të eksplodojnë. Rrezik lëndimi dhe dëmtimi material!
- Mos përdorni ose vendosni materiale të ndjeshme ndaj temperaturës siç janë spreji i ndezshëm, objekte të ndezshme, akull të thatë ose agjentë të tjerë kimikë në afërsi të frigoriferit. Rrezik zjarri dhe shpërthimi!
- Mos ruani materiale shpërthyes si kanaçe aerosol me materiale të ndezshme brenda produktit.
- Mos vendosni mbi produkt kanaçe që përmbajnë lëngje. Spërkatja e ujit në një pjesë elektrike mund të shkaktojë rrezikun e shokut elektrik ose zjarrit.
- Ky produkt nuk është i destinuar për ruajtjen dhe ftohjen e barnave, plazmës së gjakut, preparateve laboratorike ose materialeve dhe produkteve të ngjashme që i nënshtrohen Direktivës për Produkte Mjekësore.
- Nëse produkti përdoret kundër qëllimit të tij të synuar, mund të shkaktojë dëmtim ose përkeqësim të produkteve të mbajtura brenda.
- Nëse frigoriferi juaj është i pajisur me dritë të kaltër, mos e shikoni këtë dritë me pajisje optike. Mos shikoni drejtpërdrejt në dritën UV LED për një kohë të gjatë. Rrezet ultravjollcë mund të shkaktojnë tendosje të syve.
- Mos e mbushni produktin me më shumë ushqim sesa kapaciteti i tij. Mund të ndodhin lëndime ose dëmtime nëse përmbajtja e frigoriferit bie kur hapet dera. Probleme të ngjashme mund të ndodhin kur një objekt vendoset mbi produkt.
- Sigurohuni që të keni hequr çfarëdo akulli ose uji që mund të ketë rënë në dyshe me për të parandaluar lëndimet.
- Ndryshoni vendndodhjet e rafteve/rafteve të shisheve në derën e frigoriferit tuaj vetëm kur raftet janë bosh. Rrezik lëndimi fizik!
- Mos vendosni mbi produkt objekte që mund të bien/të përmbysen. Këto objekte mund të bien gjatë hapjes ose mbylljes së derës dhe të shkaktojnë lëndime dhe/ose dëme materiale.
- Mos goditni ose ushtroni presion të tepërt në sipërfaqet e qelqit. Xhami i thyer mund të shkaktojë lëndime dhe/ose dëme materiale.
- Sistemi i ftohjes në produktin tuaj përmban ngrirës R600a. Lloji i ngrirësit të përdorur në produkt specifikohet në etiketën e llojit. Ky gaz është i djegshëm. Prandaj, bëni kujdes që të mos e dëmtoni sistemin e ftohjes dhe gypat gjatë manovrimit me produkt. - Në rast të dëmtimi të gypave;
- Mos e prekni produktin ose kordonin e rrymës.
- Mbajeni produktin larg burimeve të mundshme të zjarrit që mund të shkaktojnë që produkti të marrë flakë.
- Ajroseni zonën ku vendoset produkti. Mos përdorni ventilator.
- Kontaktoni shërbimin e autorizuar.
- Nëse produkti është i dëmtuar dhe vëreni rrjedhje gazi, ju lutemi qëndroni larg gazit. Gazi mund të shkaktojë morth nëse bie në kontakt me lëkurën tuaj.

## Udhëzimet lidhur me sigurinë

### 1.7 Siguria e mirëmbajtjes dhe pastrimit

- Nëse duhet ta lëvizni produktin për qëllime pastrimi, mos e tërhiqni nga doreza e derës. Doreza mund të shkaktojë lëndime nëse tërhiqet shumë fort.
- Mos e pastroni produktin duke spërkatur ose derdhur ujë mbi produkt dhe brenda produktit. Rrezik shoku elektrik dhe zjarr.
- Mos përdorni mjete të mprehta ose gërryese për të pastruar produktin. Mos përdorni materiale si agjentë pastrimi shtëpiake, detergjente, gaz, benzinë, alkool, dyll, etj.
- Përdorni mjete pastrimi dhe mirëmbajtjeje që nuk janë të dëmshme për ushqimin vetëm brenda produktit.
- Mos përdorni avull materiale pastrimi me avull për pastrimin e produktit dhe shkrirjen e akullit brenda tij. Avulli kontakton zonat e ndezura në frigoriferin tuaj dhe shkakton qark të shkurtër ose goditje elektrike!
- Kujdesuni të mbani ujin larg qarqeve elektronike ose ndriçimit të produktit.
- Përdorni një leckë të pastër dhe të thatë për të fshirë pluhurin ose materialin e huaj në majat e prizave. Mos përdorni një copë leckë të lagur për të pastruar prizën. Përndryshe mund të ndodhë një rrezik i shokut elektrik ose lëndimit.

### 1.8 HomeWhiz

(Mund të mos jetë i zbatueshëm për të gjitha modelet)

- Ndiqni paralajmërimet e sigurisë edhe nëse jeni larg produktit gjatë përdorimit të produktit nëpërmjet aplikacionit HomeWhiz. Gjithashtu, kushtojini vëmendje paralajmërimeve në aplikacion.

### 1.9 Ndriçimi

(Mund të mos jetë i zbatueshëm për të gjitha modelet)

- Kontaktoni një shërbim të autorizuar kur do të zëvendësoni LED / llambën e ndriçimit.

## 2 Udhëzimet mjedisore

### 2.1 Pajtueshmëria me Direktivën e WEEE dhe asgjësimi i produkteve të mbeturinave:



Ky produkt është në përputhje me Direktivën EU WEEE (2012/19EU). Ky produkt mbart simbolin e klasifikimit për pajisjet mbeturina elektrike dhe elektronike (WEEE).

Ky simbol tregon se ky produkt nuk duhet të hidhet me mbeturina të tjera shtëpiake në fund të përdorimit të tij. Pajisja e përdorur duhet të kthehet të pika zyrtare e grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Për të gjetur këto sisteme grumbullimi, ju lutemi kontaktoni autoritetet lokale ose shitësin ku është blerë produkti. Çdo familje luan një rol të rëndësishëm në rikuperimin dhe riciklimin e pajisjes së vjetër. Hedhja e duhur e pajisjes së përdorur ndihmon në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

### 2.2 Pajtueshmëria me Direktivën RoHS

Produktin që keni blerë përputhet me Direktivën EU RoHS (2011/65/EU). Ai nuk përmban materiale të dëmshme dhe të ndaluara të specifikuara në Direktivë.

### 2.3 Informacione për paketimin



Materialet e paketimit të produktit janë prodhuar nga materiale të riciklueshme në përputhje me Rregullat

Kombëtare për Mjedisin.


### 2.4 Pajtueshmëria me Direktivën RoHS

Produktin që keni blerë përputhet me Direktivën EU RoHS (2011/65/EU). Ai nuk përmban materiale të dëmshme dhe të ndaluara të specifikuara në Direktivë.

### 2.5 Informacione të paketimit

Materialet e paketimit të produktit janë prodhuar nga materiale të riciklueshme në përputhje me Rregullat Kombëtare për Mjedisin. Mos i hidhni materialet e paketimit së bashku me mbeturinat e tjera ose ato shtëpiake. Çojini në pikat e grumbullimit të materialeve të paketimit të caktuara nga autoritetet lokale.

### 3 Frigoriferi juaj



- |    |                                      |     |                     |
|----|--------------------------------------|-----|---------------------|
| 1. | Raftet e rregullueshme të derës      | 6.  | Dhomëza për akull   |
| 2. | Tabakierja e vezëve                  | 7.  | Krisperi            |
| 3. | Rafti i shisheve                     | 8.  | Raftet e lëvizshme: |
| 4. | Këmbëza të përparme të rregullueshme | 9.  | Ventilatori         |
| 5. | Dhomëza e ngrirësit                  | 10. | Llampa ndriçuese    |

**\*Mund të mos jetë i disponueshëm për të gjitha modelet**



Figurat që ndodhen në këtë manual janë skematike dhe mund të mos korrespondojnë saktësisht me produktin tuaj. Nëse pjesët e subjektit nuk janë përfshirë në produktin që keni blerë, atëherë është vlejshëm të keni parasysh modelet të tjera.

## 4 Instalimi

 Sigurohuni që së pari t'i lexoni „udhëzimet e sigurisë“!

### 4.1 Vendndodhja

#### e përshtatshme për instalim

Kontakti shërbimin e autorizuar për instalimin e produktit. Për të përgatitur produktin për përdorim, referojuni informacionit në manualin e përdorimit dhe sigurohuni që instalimi elektrik dhe instalimi i ujit janë të përshtatshëm. Nëse jo, telefononi një elektrikist dhe teknik të kualifikuar për të kryer çdo rregullim të nevojshëm.

|                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|-----------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|   | <b>PARALAJMËRIM:</b> Prodhuksi nuk mban përgjegjësi për dëmet që mund të lindin nga procedurat e kryera nga persona të paautorizuar.                                                                                                                                            |
|   | <b>WARNING:</b> Produkti nuk duhet të futet në prizë gjatë instalimit. Përndryshe, mund të shkaktohet vdekje ose lëndime serioze!                                                                                                                                               |
|  | <b>PARALAJMËRIM:</b> Nëse hapësira e derës së dhomës ku do të vendoset produkti është aq e ngushtë sa që pamundëson kalimin e produktit, hiqeni derën e dhomës dhe kaloni produktin përmes derës duke e kthyer anash; nëse kjo nuk funksionon, kontakti shërbimin e autorizuar. |

- Vendoseni frigoriferin mbi një sipërfaqe të sheshtë për t'i parandaluar lëkundjet.
- Instaloni produktin të paktën 30 cm larg nga burimet e nxehtësisë, siç janë pianurat, furrat, ngrohësit dhe sobat, si dhe të paktën 5 cm larg nga furrat elektrike.
- Produkti nuk duhet t'i ekspozohet dritës së drejtpërdrejtë të diellit dhe të mbahet në vende me lagështi.
- Për të arritur një funksionim efikas duhet të sigurohet ventili i përshtatshëm i ajrit rreth produktit tuaj. Nëse produkti do të vendoset në një


çarje brenda murit, kujdesuni të lini të paktën 5 cm distancë me tavanin dhe muret anësore.

- Siguroni të paktën 5 cm distancë për qarkullimin e ajrit midis pjesës së pasme të produktit tuaj dhe murit për të shmangur kondensimin në panelin e pasmë të produktit.
- Produkti juaj kërkon qarkullim të përshtatshëm të ajrit për të funksionuar në mënyrë efikase. Nëse produkti do të vendoset brenda një kthine, mos harroni të lini të paktën 5 cm hapësirë midis produktit dhe tavanit, murit të pasmë dhe mureve anësore.
- Nëse produkti do të vendoset brenda një kthine, mos harroni të lini të paktën 5 cm hapësirë midis produktit dhe tavanit, murit të pasmë dhe mureve anësore. Kontrolloni nëse komponenti mbrojtës i hapësirës së pasme të murit është i pranishëm në vendndodhjen e tij (nëse sigurohet me produktin). Nëse komponenti nuk është i disponueshëm, ose nëse humbet ose ka rënë, poziciononi produktin në mënyrë që të lihet të paktën 5 cm hapësirë midis sipërfaqes së pasme të produktit dhe murit të dhomës. Hapësira në pjesën e pasme është e rëndësishme për funksionimin efikas të produktit.

# Instalimi

## 4.2. Rregullimi i këmbëve

Nëse produkti qëndron i çekuilibruar pas instalimit, rregulloni këmbët në pjesën e përparme duke i rrotulluar djathtas ose majtas.



## 4.3. Electrical Connection



**PARALAJMËRIM:** Mos bëni lidhje me anë të kablove zgjatuese ose pajisjeve me shumë priza.



**PARALAJMËRIM:** Kabloja e dëmtuar e energjisë duhet të zëvendësohet nga agjenti i autorizuar i shërbimit.



Nëse instalohen dy pajisje ftohëse pranë njëra-tjetrës, duhet të ketë një distancë të paktën 4 cm midis tyre.

- Kompania jonë nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë dëmtim që do të ndodhë kur produkti përdoret pa tokëzim dhe lidhje elektrike në përputhje me rregulloret kombëtare.
- Priza e kordonëve të rrymës duhet të jetë lehtësisht e arritshme pas instalimit.
- Mos lidhni kablo zgjatuese ose pajisje me priza të shumëfishta pa tela ndërmjet produktit tuaj dhe prizës në mur.

### Paralajmërim për sipërfaqe të nxehtë!




Muret anësore të produktit tuaj janë të pajisura me gypa ftohëse për të përmirësuar sistemin e ftohjes. Ftohësi me temperatura të larta mund të rrjedhë nëpër këto zona, duke shkaktuar sipërfaqe të nxehta në muret anësore. Kjo është normale dhe nuk ka nevojë për ndonjë shërbim. Ju lutemi kushtojini vëmendje kur prekni këto zona.

## 4.4. Lidhja e pykave të plastikes

Përdorni pykat plastike në pajisjen e sjellë me produktin për të siguruar hapësirë të mjaftueshme për qarkullimin e ajrit midis produktit dhe murit.


1. Për të ngjitur pykat, hiqni vidhat në produkt dhe përdorni vidhat e dhëna me pykat.
2. Ngjitni 2 pyka plastike në kapakun e ventilimit siç tregohet në figurë.



## 5 Përgatitja


**!** Sigurohuni që së pari t'i lexoni „udhëzimet e sigurisë“!

- Për një pajisje me qëndrim të lirë; "Kjo pajisje ftohëse nuk është menduar për t'u përdorur si një pajisje e integruar.
- Frigoriferi juaj duhet të montohet të paktën 30 cm larg burimeve të nxehtësisë si sobat, furrat, ngrohjet qendrore dhe stofat dhe të paktën 5 cm larg nga furrat elektrike dhe nuk duhet të vendoset nën dritën direkte të diellit.
- Temperatura e ambientit të dhomës ku do të instaloni produktin duhet të jetë të paktën +5°C. Përdorimi i frigoriferit në kushte më të ftohta nuk rekomandohet për sa i përket efikasitetit të tij.
- Ju lutem sigurohuni që pjesa e brendshme e frigorifeirt të pastrohet plotësisht.
- Nëse do të montohen dy frigoriferë njëri pas tjetrit, duhet të ketë një distancë të paktën 2 cm midis tyre.
- Kur e vini frigoriferin në punë për herë të parë, ju lutem përmbajuni udhëzimeve të mëposhtme gjatë gjashtë orëve të para.
- Dera nuk duhet të hapet shpesh.
- Duhet të vihet në punë bosh pa ushqime në të.
- Mos e hiqni frigoriferin nga priza. Nëse ndodh një ndërprerje energjie që nuk e keni ju në dorë, ju lutem shikoni paralajmërimet në pjesën "Zgjidhjet e rekomanduara për problemet".
- Paketimi dhe materialet e shumës origjinale duhet të ruhen për transport ose lëvizje në të ardhmen.
- Shportat/sirtarët që vijnë me dhomëzën e ftohjes duhet të jenë gjithmonë në përdorim, për konsum të ulët të energjisë dhe për kushte më të mira ruajtjeje.
- Kontakti i ushqimit me sensorin e temperaturës në dhomëzën e ngrirësit mund të rrisë konsumin e energjisë së pajisjes. Kështu që çdo kontakt me sensorin(sensorët) duhet të shmanget.
- Në disa modele, paneli i mjeteve fiket automatikisht 1 minutë pasi dera të jetë mbyllur. Do të riaktivizohet kur dera të hapet ose të shtypet ndonjë pullë.
- Për shkak të ndryshimit të temperaturës si rezultat i hapjes/mbylljes së derës së produktit gjatë përdorimit, kondensimi në raftet e derës/trupit dhe në kontejnerët e qelqit është normal.
- Pasi ajri dhe lagështia nuk do të depërtojnë direkt në produkt kur dyert nuk janë të hapura, produkti juaj do të optimalizohet në kushte të mjaftueshme për ta mbrojtur ushqim tuaj. Funkcionet dhe pjesët si kompresori, erashka, nexhja, shkrrirja, ndriçimi, ekrani dhe kështu me radhë do të funksionojnë sipas nevojave për të konsumuar energji minimale në këto rrethana.
- Në rast se ekzistojnë opsione të shumta, raftet e qelqit duhet të vendosen në mënyrë që daljet e ajrit në pjesën e pasme të mos bllokohen, mundësisht daljet e ajrit të mbeten poshtë raftit të xhamit. Ky kombinim mund të ndihmojë në përmirësimin e shpërndarjes së ajrit dhe efikasitetit të energjisë.



## 6 Përdorimi i produktit

### Paneli i kontrollit të produktit



1 Treguesi i statusit të gabimit

3 \* Funksioni OFF/FIKUR

(Vacation/Pushime) i dhomëzës së ftohjes

5 Tasti i konfigurimit të temperaturës së dhomëzës së ngrirësit

2 Tasti i konfigurimit të temperaturës së dhomëzës së ftohjes

4 Treguesi i kursimit të energjisë (Ekran i fikur).

6 Tasti i ngrirjes së shpejtë



Në fillim lexoni pjesën  
"Udhëzimet për sigurinë".

Funksionet dëgjimore dhe vizuale në panelin tregues do t'ju ndihmojnë si të përdorni frigoriferin.

**\*Opsionale:** Funksionet e paraqitura janë opsionale; ato mund të ndryshojnë në formë dhe pozicion në funksionet që gjenden në panelin tregues të pajisjes suaj.

#### 1. Treguesi i gjendjes së gabimit !

Ky tregues do të jetë aktiv kur frigoriferi nuk mund të bëjë ftohjen e duhur ose në rast të ndonjë gabimi të sensorit. Mund të shfaqet shenja e pikëçuditjes kur vendosni ushqime

shenja e pikëçuditjes kur vendosni ushqime të ngrohta në dhomëzën e ngrirësit ose kur e mbani derën hapur për një kohë të gjatë. Kjo nuk tregon defekt; ky paralajmërim hiqet kur ushqimi ftohet ose kur shtypet ndonjë tast.

#### 2. Tasti i konfigurimit të temperaturës së dhomëzës së ftohjes °C

Mundëson konfigurimin e temperaturës për dhomëzën e ftohjes. Shtypja e tastit do të bëjë që temperatura e dhomës së ftohjes të vendoset në 8°C, 6°C, 4°C, dhe 2°C.

## Përdorimi i produktit

### 3. Funkzioni Off/Fikur (Vacation/ Pushime) i dhomëzës së ftohjes

Për të aktivizuar funksionin „Vacation“ shtypni butonin për 3 sekonda. Gjendja „Vacation“ aktivizohet dhe drita LED në simbolin „Vacation“ ndizet. Dhomëza e ftohësit nuk kryen funksionin aktiv të ftohjes. Nëse e aktivizoni këtë funksion, atëherë nuk duhet t'i ruani ushqimet në dhomëzën e ftohësit. Dhomëzat e tjera vazhdojnë të ftohen sipas temperaturave të vendosura më parë.

Shtypni përsëri butonin për 3 sekonda për të anuluar këtë funksion.

### 4. Treguesi i kursimit të energjisë (ekran i fikur).

Kur dyert nuk hapen dhe mbyllen për një kohë të gjatë, gjendja e kursimit të energjisë aktivizohet automatikisht dhe simboli i kursimit të energjisë ndizet. Kur aktivizohet funksioni i kursimit të energjisë, të gjitha simbolet, përveç atij të kursimit të energjisë, zhduken nga ekrani. Kur funksioni i kursimit të energjisë është aktiv, shtypja e ndonjë tasti ose hapja e derës do të çaktivizojë funksionin e kursimit të energjisë dhe sinjalet e ekranit do të kthehen në gjendjen normale. Funkzioni i kursimit të energjisë është një funksion i aktivizuar nga fabrika dhe nuk mund të anulohet.

### 5. Tasti i konfigurimit të temperaturës së

#### dhomëzës së ngrirësit

Konfigurimi i temperaturës është bërë për dhomëzën e ngrirësit. Shtypja e tastit do të bëjë që temperatura e dhomëzës së ngrirësit të vendoset në vlerat -18°C, -20°C, -22°C, dhe -24°C.

### 6. Tasti i ngrirjes së shpejtë

Kur shtypet tasti i ngrirjes së shpejtë, drita LED në tastin e ngrirjes së shpejtë ndizet dhe funksioni i ngrirjes së shpejtë do të aktivizohet. Temperatura e dhomëzës së ngrirësit është vendosur në -27°C.

Shtypni përsëri tastin për të anuluar funksionin. Funkzioni i ngrirjes së shpejtë do të anulohet automatikisht pas një periudhe të caktuar. Për të ngrirë një sasi të madhe ushqimesh të freskëta, shtypni tastin e ngrirjes së shpejtë përpara se t'i vendosni ushqimet në dhomëzën e ngrirësit.

## 6.1. Ndryshimi i llambës së ndriçimit

Për të ndryshuar llambën/LED që përdoret për ndriçimin e frigoriferit tuaj, telefononi shërbimin tuaj të autorizuar. Llambat e përdorura në këtë pajisje nuk janë të përshtatshme për ndriçimin e dhomës shtëpiake. Qëllimi isyruar i kësaj llambë është të ndihmojë përdoruesin që të vendosë produktet ushqimore në frigorifer/ frigorifer me ngrirje të thellë në mënyrë të sigurt dhe të rehatshme.

Llambat e përdorura në këtë pajisje duhet t'i rezistojnë kushteve fizike ekstreme si temperaturat nën -20 °C.

**(vetëm kraharori dhe ngrirës i pjesës së sipërme)**

## 6.2. Ndryshimi i drejtimit të hapjes së derës

Drejtimi i hapjes të derës të frigoriferit tuaj mund të ndryshohet sipas vendit ku do ta përdorni. Nëse është e nevojshme kjo, ju lutem thërrisni Shërbimin e utorizuar më të afërt.

## 6.3. Paralajmërimi për derën e hapur

Një paralajmërim audio do të dëgjohet kur dera e dhomëzës së frigoriferit ose ngrirësit të produktit tuaj të lihet e hapur për një periudhë të caktuar kohore. Ky sinjal paralajmërues audio do të ndalet kur shtypet ndonjë buton në tregues ose kur dera është e mbyllur.

### 6.4. Moduli i deodoruesit

#### (FreshGuard)

Moduli i deodorantit eliminon shpejt erërat e këqija në frigorifer përpara se të depërtojnë në sipërfaqe. Falë këtij moduli, i cili vendoset në pjesën e sipërme të dhomëzës së ushqimit të freskët, erërat e këqija shpërndahen derisa ajri kalon në mënyrë aktive në filtrin e erërave, pastaj ajri që është pastruar nga filtri lëshohet sërish në dhomëzën e ushqimit të freskët. Në këtë mënyrë, erërat e padëshiruara që mund të shfaqen gjatë ruajtjes së ushqimeve në frigorifer eliminohen para se të depërtojnë në sipërfaqe.

Kjo arrihet falë ventilatorit, dritës LED dhe filtrit të erërave të integruar në modul. Në përdorim të përditshëm, moduli i deodorantit ndizet automatikisht në baza të herëpashershme. Për të ruajtur performancën efikase, rekomandohet që filtri të vendoset në modulin e deodorantit nga ofruesi i shërbimit të autorizuar çdo 5 vjet. Për shkak të ventilatorit të integruar në modul, zhurma që do të dëgjoni gjatë përdorimit është normale. Nëse hapni derën e dhomëzës së ushqimeve të freskëta, ndërsa moduli është aktiv, ventilatori do të ndalojë përkohësisht dhe do të rifillojë aty ku është ndërprerë pas njëfarë kohe, kur dera të mbyllet përsëri. Në rast të ndërprerjes së rrymës, moduli i deodorantit do të rifillojë aty ku ka ndërprerë kohëzgjatjen totale të operimit sapo të kthehet rryma.



Rekomandohet ruajtja e ushqimeve aromatike (si djathi, ullinjë dhe ushqimet gjysmë të gatshme) në paketimin e tyre dhe të sigurohen për të shmangur erërat e këqija që mund të rezultojnë kur erërat e ushqimeve të ndryshme të përzieren. Përveç kësaj, rekomandohet që ushqimet e prishura të nxirren shpejt nga frigoriferi për të parandaluar që ushqimet e tjera të prishen dhe të shmangen aromat e këqija.

### 6.5. Drita e kaltër/“HarvestFresh“

**\*Mund të mos jetë i disponueshëm për të gjitha modelet**

**Për dritën e kaltër,**

Frutat dhe perimet e ruajtura në koshin e freskët që ndriçohen me dritë të kaltër vazhdojnë fotosintezën e tyre me anë të efektit të gjatësisë së valës së dritës së kaltër dhe kështu ruajnë përmbajtjen e tyre të vitaminave.

**Për HarvestFresh,**

Frutat dhe perimet e ruajtura në drithëra të ndriçuara me teknologjinë HarvestFresh ruajnë vitaminat e tyre për një kohë më të gjatë falë cikleve të kaltër, jeshilë, të kuqë dhe të errëta, të cilat simulojnë një cikël ditor.

Nëse e hapni derën e frigoriferit gjatë periudhës së errët të teknologjisë HarvestFresh, frigoriferi do ta kuptojë automatikisht këtë dhe do të mundësojë dritën blu-jeshile ose të kuqe të ndriçojë koshin e freskët për lehtësinë tuaj. Pasi të keni mbyllur derën e frigoriferit, periudha e errët do të vazhdojë, duke përfaqësuar kohën e natës në një cikël të ditës.

### 6.6. Koshi i perimeve me lagështi të kontrolluar (EverFresh+) \*opsional

Me veçorinë e kontrollit të lagështisë, përqindja e lagështisë të perimeve dhe frutave mbahet në kontroll dhe garanton një periudhë freskie më të gjatë për ushqimet.

Rekomandohet që t'i mbani perimet me gjethe si marulet dhe spinaqin dhe perimet e ngjashme të cilat humbasin lagështi jo mbi rrënjët e tyre por në pozicion horizontal në koshin e perimeve sa më shumë të jetë e mundur. Kur vendosni perimet, vendosni perimet e rënda dhe të forta në fund dhe ato të lehta dhe të buta sipër, duke marrë parasysh peshën e perimeve.

Mos i lini perimet në koshin e perimeve brenda qeseve plastike. Lënia e tyre në qese plastike bën që perimet të prishen shpejt. Në situata ku nuk preferohet kontakti me perime të tjera, përdorni materiale paketimi si letër që ka porozitet të caktuar për sa i përket higjienës.

Mos vendosni fruta që kanë një prodhim të lartë të gazit etilien si dardhat, kajsitë, pjeshkët dhe veçanërisht mollët në të njëjtin kosh perimesh me perimet dhe frutat e tjera. Gazi etilien që del nga këto fruta mund të bëjë që perimet dhe frutat e tjera të piqen më shpejt dhe të prishen brenda një kohe më të shkurtër.

## Përdorimi i produktit

Në mënyrë që të ruani frutat dhe perimet tuaja në kushte ideale lagështie, mund të ndryshoni vendndodhjen e shulës në koshin e freskët. Nëse ruhen vetëm frutat dhe perimet, vendoseni shulën te frutat; nëse ruhen vetëm perimet, vendoseni shulën te perimet, nëse ruhen artikujt të përzier, vendoseni shulën në parametër të përzier.

### 6.7. Ngrirja e ushqimeve të freskëta

